

Le t'u përcjellim viktimave të dhunës mesazhin e solidaritetit dhe t'u kujtojmë atyre se nuk janë vetëm, por gëzojnë mbështetjen ligjore dhe atë të një shoqërie gjithmonë e më të ndërgjegjshme ndaj faktit se dhuna, veçanërisht ajo familjare, është **shkelje e të drejtave të njeriut**, me pasoja të rënda për të gjithë shoqërinë

Më 1 qershor 2007 hyri në fuqi **ligji kundër dhunës në familje**, viktimat të së cilës janë kryesisht gratë dhe fëmijët. Ky ligj është një mjet i rëndësishëm në duart e viktimave, për të siguruar mbrojtje më të përshtatshme dhe parandalim të mëtejshëm të episodeve të rënda.

Projekti i UNDP-së "*Dhuna në Familje-Jo më çështje e brendshme e familjes*", së bashku me agjenci të tjera të Kombeve të Bashkuara, ka ofruar mbështetjen e tij për qeverinë shqiptare, në hartimin e së parës Strategji Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje, nëpërmjet një procesi gjithëpërfshirës të qeverisë, organizmave joqeveritare dhe organizatave të shoqërisë civile duke i kushtuar rëndësi të veçantë ndërgjegjesimit të brezave të rinj ndaj këtij fenomeni.

Mbi 2 000 organizata në 154 vende marrin pjesë në Fushatën 16-Ditore që prej vitit 1991!

Dy fjalë për historikun e fushatës

Mbi 2 000 organizata në 154 vende marrin pjesë në fushatën 16-ditore që prej fillimit të saj në vitin 1991. Kjo fushatë vjetore që zhvillohet më 25 nëntor deri më 10 dhjetor, është përdorur si strategji e organizuar nga individë dhe grupe nga e gjithë bota për t'u dhënë fund të gjitha formave të dhunës dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, duke kërkuar thellimin e nismave të marra nga qeveritë e vendeve si dhe duke propozuar nisma të reja për të luftuar këtë fenomen të shëmtuar.

Fushata fillon me 25 nëntorin që shënon pikërisht Ditën Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Grave dhe mbyllet me 10 dhjetorin, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut. Periudha 16-ditore përfshin edhe data të tjera domethënëse si 1 dhjetorin Dita Mbarëbotërore kundër HIV/AIDS dhe 20 nëntorin, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Fëmijëve.

Strategjitë e zbatuara gjatë kësaj fushate nga grupe dhe individë nga e gjithë bota kanë qenë gjithmonë unike. Në qoftë se edhe ju keni për të rrëfyer një ngjarje a për të dhënë idetë tuaja për t'i thënë "Jo!" dhunës në familje bëhuni pjesë e diskutimeve online në faqen e internetit të Qendrës për Studimet Gjinore:

www.fss.gi.edu.al

Ligji i ri kundër dhunës në marrëdhëniet familjare ofron një mundësi të re mbrojtjeje nga dhuna në familje. Që nga 1 qershori 2007, cdokush mund t'i drejtohet gjykatës për të marrë një urdhër mbrojtjeje të përkohshëm për vete apo familjarët e tij/saj që rrezikohen nga dhuna.

Nëpërmjet urdhrit të mbrojtjes gjykata mund:

- Të ndalojë dhunuesin të kryejë, ose të kërcënojë se do të kryejë ndonjë veprë tjetër që konsiderohet dhunë në familje
- Të detyrojë dhunuesin të largohet nga banesa e përbashkët, edhe sikur ai/ajo të ketë pronësi mbi atë banesë
- Të ndalojë dhunuesin për t'iu afruar viktimës a familjarëve të saj, shtëpisë, shkollës, qendrës së punës
- Të mundësojë strehimin e viktimës e familjarëve të saj në një vend të sigurt.
- Të urdhërojë strukturat zbatuese të ligjit për t'iu ofruar shoqërim viktimës a dhunuesit, p.sh. për të marrë plaçka nga banesa apo për t'u vendosur në një strehëz të sigurt
- Mund të urdhërojë dhunuesin të paguajë detyrim ushqimor për fëmijën/t për sa kohë zgjat urdhri i mbrojtjes, etj.

Institucionet e ngarkuara me detyrim nga ligji për dhunën në familje

Veç, gjykatës, e cila luan rol në lëshimin e urdhrat të mbrojtjes, edhe institucionet e mëposhtme kanë detyrime ligjore për të vepruar në mbrojtje të viktimave të dhunës në familje

- **Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta**, si institucioni kryesor përgjegjës dhe strukturë koordinuese
- **Ministria e Brendshme dhe strukturat e Policisë së Shtetit**
- **Ministria e Drejtësisë**, me strukturat e drejtuara prej saj, si shërbimi mjeko-ligjor e përmbarimi gjyqësor, si dhe me funksionet që gjejnë rregullim prej saj, si për shembull, ndihma me avokat falas për viktimat e dhunës në familje
- **Ministria e Shëndetësisë**, me strukturat e saj vartëse, sidomos qendrat shëndetësore dhe shërbimet e urgjencës mjekësore
- **Organet e qeverisjes vendore**



Fjongoja vjollcë është simboli i përpjekjeve të përbashkëta kundër dhunës ndaj gruas.

Ju inkurajojmë ta mbani këtë simbol NË SHENJË SOLIDARITETI ME NE




JAPAN
Official Development Assistance



Albania

THYEJE HESHTJEN! NUK JE VETËM!



UNZIP punim nga Soena Lame, nxënëse e Shkollës së Mesme Artistike "Jordan Misja", Tiranë dhe fituese e çmimit të parë në Ekspozitën Kundër Dhunës në Familje organizuar nga UNDP

Bëhuni pjesë e fushatës 16-ditore mbarëbotërore KUNDËR DHUNËS!